



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



Datë: 18.08.2023
02 Nr.400/01-21432/23

PROCESVERBAL

**Dëgjimi Buxhetor në Bellobrad, me banorët e fshatrave Zgatar,
Brrut, Bellobrad, Zym, Qollopek**
I mbajtur më 18.08.2023, e premte, duke filluar nga ora 18:00
VENDI: ShFMU “Sezai Surroi” - Bellobrad

Njoftimi për këtë Dëgjim Buxhetor është publikuar:

Në uebfaqe zyrtare të Komunës më 12.08.2023:

Shqip: <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/08/Degjimi-Bellobrad-1.pdf>

Boshnjakisht: <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/08/Rasprava-Bellobrad.pdf>

Në Facebook-un zyrtar më 14.08.2023:

Shqip:<https://www.facebook.com/photo.php?fbid=638768865018967&set=pb.100066575766996.-2207520000&type=3>

Boshnjakisht:<https://www.facebook.com/photo/?fbid=638777341684786&set=pb.100066575766996.-2207520000>

Në këtë takim nga Kabineti i Kryetarit të Komunës morën pjesë:

1. Bexhet Xheladini - Kryetar
2. Qamil Kolloni – Drejtor për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim
3. Vetim Ramadani – Drejtor i Administratës
4. Fari Kolloni – Zyrtar për Informim

Pjesëmarrës në këtë dëgjim buxhetor kanë qenë gjithsej 22 persona, të cilët janë nënshkruar në Listën e pjesëmarrësve. Prej tyre kanë qenë:

1. Femra: 2
2. Meshkuj: 20

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës së Dragashit, Bexhet Xheladini

Bexhet Xheladini: Përshëndetje për të gjithë pjesëmarrësit! E vlerësoj prezencën tuaj në këtë dëgjim buxhetor. Është obligimi ynë si ekzekutiv që ta prezantojmë para jush projekt-buxhetin për vitin 2024, ndërsa prezenca juaj këtu është përmbushje e një obligimi moral e qytetar. Këtë vit buxheti është më i madh se vitin e kaluar. Pas këtyre dëgjimeve buxhetore, ku do t'i marrim kërkesat dhe sugjerimet e juaja, në shtator do ta finalizojmë draft-buxhetin dhe do t'ia paraqesim Asamblesë Komonale për miratim. Pjesa më e rëndësishme e buxhetit për ne është ajo e investimeve kapitale. Këtë vit do të kemi më pak ndarje buxhetore nëpër fshatrave, për shkak se shumica e buxhetit do të destinohet për projektin e Ujësjellësit kryesor, dhe një pjesë tjetër për ndërtimin e fabrikës së ujit. Me ardhjen në pushtet e kemi ritenderuar projektin e Ujësjellësit, pa ndryshime. Ky rrjet do të kushtojë afërsisht 2.5 milionë euro.

Qamil Kolloni, drejtor për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim prezanton para të pranishmëve Listën preliminare të shpenzimeve kapitale të parapara për vitin 2024.

Kërkesat e qytetarëve

Vetim Sadikaj, kryetar i fshatit Bellobrad:

- Problemi kryesor për fshatin Bellobrad është rrjeti i Ujësjellësit. Si do të bëhet shpërndarja e rrjetit?

Rinor Qollopeku, banor i fshati Qollopek:

- Për fshatin Zym, përveç kanalizimit, cilat janë projektet e tjera të parapara?
- Kubëzimi që është propozuar nga kryesia e fshatit, nuk është pyetur askush. Ajo është një rrugë malore që nuk kalon askush. A mund ta bëjmë një kërkesë zyrtare që me ato para ta bëjmë ndonjë projekt tjetër më të mirë?

Fehmi Selaj, banor i fshati Zym:

- Te kubëzimi, a është specifikuar saktë pjesa e kubëzimit se ku do të bëhet?
- Në fshatin Zym kemi nevojë për një ministacion të autobusëve.

Ilir Bajrami, banor i fshatit Zgatar:

- Me këtë buxhet, a duhet ne t'i caktojmë prioritetet për investime në fshatin Zgatar?

Shaban Skenderi, banor i fshatit Brrut:

- Ju përgëzoj për punën! Projekti i Ujësjellësit është një vepër kapitale.
- Ne i kemi paraqit kërkesat tona për fshatin dhe besojmë se jeni të gatshëm që t'i mbuloni.

Beqir Beqaj, banor i fshatit Bellobrad:

- Sa e keni paraparë shumë për investime në Bellobrad dhe a i keni specifikuar se ku do të destinohen ato mjete?
- Nëse keni mundësi të bëni një rregullore për çështjen e mbeturinave. Kemi banrë që i hedhin mbeturinat kudo në fshat dhe ato kundërmojnë erë të keqe.

Xhemali Iljazi, banor i fshatit Zgatar:

- Është mirë që t'i mbledhni kryetarët dhe kryesitë e fshatrave dhe të caktoni prioritetet, kemi qef që të dëgjohet zëry ynë dhe i asambleistëve tanë. Si fshat kemi bërë disa projekte vetanake. Nëse mendoni të ecni mirë duhet të na pyesni neve. Linja kryesore e bahskëpunimit është kjo kryesi. Shpresojmë të kryhet me sukses projekti i Ujësjellësit.

Sehar Qaflehi, banor i fshatit Bellobrad:

- Cilësia e punimeve që po bëhen është shumë e dobët. Na duhet një kompani e vetme që i kryen punimet me cilësi. Mbikëqyrësit e punimeve nga Komuna nuk po punojnë mirë. Ju lutem t'i mbikëqyrni punimet, sepse punët po bëhen shkel e shko.

Lista e nëshkrimeve të pjesëmarrësve në dëgjim buxhetor dhe fotografitë

LISTA E PJESËMARRËSVE NË DËGJIM BUXHETOR

Vendi: BELLOBRAD

Data: 18.08.2023

Nr.	Emri dhe mbiemri	Vendbanimi	Nënshkrimi
1	SHARR BAHTIJARI	BELLOBRAD	[Signature]
2	VEJON DAFLESHI	BELLOBRAD	[Signature]
3	Armond Daffeshi	Bellobrad	[Signature]
4	Agon Baxhale	Bellobrad	[Signature]
5	BEQIR BEQIR	BELLOBRAD	[Signature]
6	Bekir Baxhale	Bellobrad	[Signature]
7	FEHMI SELAJ	ZYM	F. Selaj
8	SHABAN SKENDËRI	BEUT	[Signature]
9	Arnjete Gheraj	Bellobrad	Arnjete Gheraj
10	Jajkos Berardi	Tym	[Signature]
11	DIJAN AZIV	BEUT	[Signature]
12	GAZEM RAMADANI	BEUT	[Signature]
13	Koston Dullapek	[Signature]	[Signature]
14	Rinor Dullapek	Dullapek	[Signature]
15	Yip Binaraj	ZGATAR	[Signature]
16	Leha Jusufi	Zgatar	[Signature]
17	Xhemal Gjon	Zgatar	[Signature]
18	VEJTIM SADIKAJ	BELLOBRAD	[Signature]
19	Sehaj Daffeshi	Bellobrad	[Signature]
20	Ali Daffeshi	Bellobrad	[Signature]
21	Fadil Bahtijari	Bellobrad	[Signature]
22	RIAD BAHTIJARI	BELLOBRAD	[Signature]

REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOVOVA
 Komuna e Dragashit
 Opština Dragash

02 Nr. Br. 400/01-21422/23
18.08.2023
 Dragash - Dragash

